



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**REKTORATI**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren shpallë:

## **KONKURS**

### **PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BAÇELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2022/2023**

Senati i Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të Statutit në mbledhjen e mbajtur më dt. 01.07.2022 dhe ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2022/23, dhe ka miratuar kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – bachelor. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

#### **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2022/2023, do të regjistroj 1130 studentë, prej të cilëve 1130 studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri 136 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen deri në 3% përkatësisht deri 36 kandidatë të cilët kanë lindur në vendet jashtë Kosovës (Shtetas të Huaj dhe nga trojet Shqiptare), ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përgjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.

7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Në Universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës.
10. Vendimi për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret nga MASHTI.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi (p.sh. në programet e Fakultetit të Filologjisë).
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në Universitet pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u ç'regjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. Kandidatët për pranim si studentë të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren në vitin akademik 2022/23 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

### **MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE**

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
  - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës, numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
    - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
  - b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës, numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
    - Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe,
    - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
  - c) Provimi pranues hartohet me 100 pikë (ku sistemi sipas aplikuesit i konverton në 70 apo 40 pikë)
2. Të drejtë pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara në provimin pranues.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara në provim pranues

nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.

4. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë pranimi kanë vetëm ata studentë që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues, vendet e lira të cilat mbesin nga pika 2 dhe 3 nuk zëvendësohen.
5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh sukcesi i shkollës mesme.

#### AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. **Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit, bëhet prej 12.07.2022 deri më 19.07.2022, nga ora 09:00-15:00 (ditë pune) ditën e fundit dokumentet pranohen deri ora 16:00. Provimi pranues do të mbahet më 21.07.2022, duke filluar prej orës 09:00 (shih tabelën me orarin e mbajtjes së provimit pranues).**
2. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç' regjistrim nga fakulteti.
3. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:
  - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinale),*
  - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë),*
  - c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),*
  - d) *Kopjen e letërnjoftimit,*
  - e) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegëza për aplikim online përmes internetit është: [www.smu.uni-prizren.com](http://www.smu.uni-prizren.com),*
  - f) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
4. Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 të këtij neni t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve.
5. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

**Orari i mbajtjes së provimit pranues është më datë 21.07.2022**

<b>Nr.</b>	<b>Data</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>Programi</b>	<b>Prej</b>	<b>Deri</b>	<b>Grupi</b>
1	21.07.2022	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	09:00	10:30	RR
2	21.07.2022	Ekonomik	Administrim Biznesi	09:00	10:30	RR
3	21.07.2022	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	11:00	12:30	RR
4	21.07.2022	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	13:00	14:30	RR
5	21.07.2022	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	13:00	14:30	RR
6	21.07.2022	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	13:00	14:30	RR
7	21.07.2022	FSHK	TIT	13:00	14:30	RR
8	21.07.2022	FSHK	TIT - Tur dhe Bos.	14:30	16:00	RR
9	21.07.2022	Edukim	Program Fillor	09:00	10:30	RR
10	21.07.2022	Edukim	Program Parafillor	11:00	12:30	RR
11	21.07.2022	Edukim	Program Fillor - Bos dhe Tur.	13:00	14:30	RR
12	21.07.2022	Edukim	Prog. Parafillor - Bos dhe Tur.	13:00	14:30	RR
13	21.07.2022	FSHJM	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	11:00	12:30	RR
14	21.07.2022	FSHJM	Agrobiznes	13:30	15:00	RR

**Shpallja e rezultateve preliminare do të bëhet më 21.07.2022 deri ora 20:00 në ueb-faqen zyrtare të Universitetit.**

**Afati për ankesa është më: 22.07-23.07.2022 (Forma e ankimimit është online) ndërsa shqyrtimi do të bëhet më 25.07.2022 duke filluar nga ora 09:00.**

**Ndërsa shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më së largu me datë 25.07.2022 më së largu ora 18:00**

**Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar do të bëhet nga data 26.07.2022 deri më 29.07.2022 prej orës 10:00-15:00 (shih tabelën e mëposhtme).**

**Kandidatët të cilët nuk regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbasin mundësinë e regjistrimit, andaj ju lutemi që t'i përmbaheni afateve të caktuara.**

### Orari i regjistrimit dhe fotografimit të studentëve të pranuar

Nr.	Fakulteti	Departamenti	Data e fotografimit	Ora
1	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
2	Ekonomik	Administrim Biznesi	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
		Menaxhment Ndërkombëtar	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
3	FSHK	T I T (Shq. Tur.Bos.)	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
4	Edukim	Fillor (Shq. Tur. Bos.)	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
		Parashkollor (Shq. Tur. Bos.)	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
5	Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
		Gjuhë dhe Letërsi Angleze	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
		Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
6	FSHJM	Agrobiznes	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00
		Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	26.07 - 29.07.2022	10:00 - 15:00

#### Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit duhet të paraqesin:

1. Fletëregjistrimin e plotësuar i cili merret me rastin e regjistrimit;
2. Një fotografi (formati 4.5 x 6 cm) të cilat duhet të bëhen nga fotograf profesionist.

Për informata më të hollësishme kandidatët duhet ta vizitojnë ueb-faqen zyrtare: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**I. Numri i studentëve të cilët do të pranohen në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren - sipas programeve është si në tabelën:**

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Kodi i programit	Për studime të rregullta	Për komunitete 12%	Kandidatët nga jashtë RKS-së 3%	Total
1	Fakulteti Juridik	Juridik i Përgjithshëm	05	85	12	3	100
2	Fakulteti Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	02	127	18	5	150
3	Fakulteti Ekonomik	Administrim Biznesi	01	85	12	3	100
4	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor	09	34	5	1	40
5	Fakulteti i Edukimit	Programi Parashkollor	10	25	4	1	30
6	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor - Bos.	11	17	2	1	20
7	Fakulteti i Edukimit	Programi Parashkollor - Bos.	12	17	2	1	20
8	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor - Tur.	13	17	2	1	20
9	Fakulteti i Edukimit	Programi Parashkollor - Tur.	14	17	2	1	20
10	Fakulteti i Shkencave Komputerike	TIT*	07	153	22	5	180
12	Fakulteti i Shkencave Komputerike	TIT* - Bos.	25	25	4	1	30
13	Fakulteti i Shkencave Komputerike	TIT* - Tur.	28	25	4	1	30
14	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	22	34	5	1	40
15	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	23	102	14	4	120
16	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	24	85	12	3	100
16	F.Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	31	42	6	2	50
17	F.Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	Agrobiznesi	30	68	10	2	80

\* TIT - Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi

**Vini re:** Në tabelën e paraqitur me kuaota për nxënësit që kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake, do të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesa dhe diploma. Përfshirim nga vërejtja e lartpërmendur përbëjnë kandidatët të cilët vijnë nga komunat në të cilat nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë. Këta kandidatë duhet ta plotësojnë formularin për vetdeklarim lidhur me përkatësinë e tyre etnike.

**LËNDËT NË PROVIM PRANUES:**

- 1. Juridik i Përgjithshëm:** Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe
- 2. Administrim Biznesi:** Hyrje në ekonomi, Matematikë
- 3. Menaxhment Ndërkombëtar:** Hyrje në ekonomi, Matematikë
- 4. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe:** Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- 5. Gjuhë dhe Letërsi Angleze:** Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- 6. Gjuhë dhe Letërsi Gjermane:** Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
- 7. Programi Fillor:** Gjuhë Shqipe (testi i të lexuarit të kuptueshëm) dhe Matematikë
- 8. Programi Parashkollor:** Gjuhë Shqipe (testi i të lexuarit të kuptueshëm) dhe Matematikë
- 9. TIT: Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë**
- 10. Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit:** Matematikë, Kimi dhe Biologji
- 11. Agrobiznesi:** Hyrje në Shkencat e natyrës, Hyrje në ekonomi dhe Matematikë

Në Gjuhën Boshnjake:

- 12. Programi Fillor:** Gjuhë amtare (testi i të lexuarit të kuptueshëm) dhe Matematikë
- 13. Programi Parashkollor:** Gjuhë amtare (testi i të lexuarit të kuptueshëm) dhe Matematikë
- 14. TIT: Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë**

Në Gjuhën Turke:

- 15. Programi Fillor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë
- 16. Programi Parashkollor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë
- 17. TIT: Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë**

Prof. Asoc. Dr. Samedin KRRABAJ

Kryesues i Senatit

